REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 24/17
Datë/Datum. 01.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH Nr. 24/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z.Blerim Dina - Kryetar, z.Tefik Sylejmani - Referues, z.Goran Milenkoviç - Anëtar, z.Ekrem Salihu - Anëtar, z.Nuhi Paçarizi – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE ankues "TTC Sh.p.k" - Prishtinë, kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit: "Furnizim me Gëlqere të hidratizuar", me nr prok: "KEKO16/022/111", iniciuar nga autoriteti kontraktues /Korporata Energjetike e Kosovës sh.a/, më datën 22.02.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. **Hedhet,** poshtë si e pa lejuar ankesa e OE "TTC Sh.p.k" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me Gëlqere të hidratizuar", kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit me nr prok: "KEKO16/022/111", iniciuar nga autoriteti kontraktues /Korporata Energjetike e Kosovës sh.a/.

II. **Vërtetohet,** vendimi i AK-së /Korporata Energjetike e Kosovës sh.a/, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Furnizim me Gëlqere të hidratizuar", me nr prok: "KEKO16/022/111".

III. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh, duhet ta informojë me shkrim Panelin shqyrtues, për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe palët tjera në procedurë.

IV. Operatorit ekonomik ankues OE "TTC Sh.p.k" - Prishtinë, i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, pasi që ankesa është hedhur poshtë.

V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 36 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit është bërë me datën 04.01.2017.

Kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik "TTC Shpk"-Prishtinë, me dt:10.01.2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt:11.01.2017 autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "TTC Shpk" –Prishtinë.

Operatori ekonomik "TTC" Sh.p.k - Prishtinë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më 23 janar 2017 me nr. 24/17, kundër njoftimit për anulimin e dhënies së kontratës me titull: "Furnizim me Gëlqere të hidratizuar", me nr prok: "KEKO16/022/111", duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 1 i LPP-së –Qëllimi i Ligjit
- Neni 10 i LPP-së –Mjetet për promovimin e transparencës
- Neni 55 i LPP-së – Mënyra e komunikimit
- Neni 59 i LPP-së –Ekzaminimi, vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 64 i LPP-së –Dështmitë e kërkesave
- Neni 66 i LPP-së- Përshtatshmëria profesionale
- Neni 67 i LPP-së- Provat shkresore
- Neni 69 i LPP-së –Aftësia teknike dhe profesionale
- Neni 70 i LPP-së – Standardet për sigurimin e cilësisë
- Neni 72 i LPP-së – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
- Neni 104 i LPP-së –Parimet themelore

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues përmes raportit të datës 09 shkurt 2017 ka lëshuar një kronologjinë në të cilën ka shqyrtuar vlefshmërinë e pretendimeve ankimore të parashtruara në ankesën e OE ankues "TTC Shpk" – Prishtinë, së pari ka njoftuar se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit OSHP ka pasur tri herë ankesa, andaj pas analizimit të ankesës së OE ankues, eksperti sqaron se pretendimi ankimor i OE ankues ka të bëjë me Certifikatën ISO 9001:2008, të lëshuar për prodhuesin US Construction nga Maqedonia, për të cilën është sqaruar në tri raporte të ekspertizave edhe tre vendimeve të Panelit Shqyrtues. Prandaj konform rregullores së punës së OSHP-së, konkretisht nenit 18.2 lidhur me rastet e unifikuara, eksperti ka njoftuar panelin shqyrtues se ky pretendim është i njëjtë, prandaj i propozoj panelit shqyrtues që të refuzohet ankesa e OE ankues për faktin se ky pretendim ankimor është gjykuar/shqyrtuar tri herë dhe se pretendimi ankimor është i njejtjë.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 22.02.2017, e cila është mbajtur pa praninë e palëve në procedurë konform nenit 28.1 të rregullores së punës së OSHP-së, ku kanë qenë prezent anëtarët e panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues ka deklaruar: "Pretendimi kryesor i OE ankues veç është shqyrtuar dhe është gjykuar nga ana e panelit shqyrtues. Për detaje tjera i gjeni më gjerësisht në kronologjinë e dorëzuar nga ana ime me datë 09.02.2017".

Paneli shqyrtues lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues, sqaron se këto pretendime janë shqyrtuar më parë dhe është vendosur edhe me vendime të OSHP-së, tri herë radhazi, ndërsa së fundmi është marr vendimi i PSH.nr.404/16 që të anulohet ky aktivitet i prokurimit, në pamundësi të verifikimit të ISO certifikatës të lëshuar për prodhuesin US Construction nga Maqedonia dhe se lënda është vendosur të dërgohet në MPB konform nenin 130 të LPP-së, ku edhe është dërguar.

Paneli shqyrtues, vjen në përfundim se pretendimet e OE ankues janë të njëjta dhe se kjo çështje konsiderohet si "Res Judikata".

Paneli shqyrtues konstaton se OE ankues "TTC Shpk" me rastin e parashtrimit të ankesës nuk ka mundur të dëshmojë dhe të argumentojë se ka interes juridiko material konform nenit 111 paragrafi 1.5 dhe 1.8 përkitazi me nenin 4 paragrafi 1.26 i LPP-së, pasi që në asnjë variant OE

ankues nuk ka mundur të përshkruajë mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Paneli Shqyrtues

z. Bleim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Korporata Energjetike e Kosovës"

1x1 OE – "TTC Sh.p.k" - Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në ëeb- faqe të OSHP-së.